

**Terma reference  
Thirrje për psikolog**

Pozicioni	Psikolog
Projekti	Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar për grupet vulnerabël si pasojë e vështirësive të shkaktuar nga emergjencat civile në Bashkinë Krujë
Zonat e projektit	Bashkia Krujë
Kohëzgjatja e projektit	Gusht 2021 – Korrik 2022
Lloji i kontratës	Kontratë Pune Individuale me kohë të pjesshme
Data e fillimit të punës	1 shkurt 2022

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të punësojë **një psikolog si pjesë e ekipit psiko-social që do të mundësojë ofrimin e një shërbimi psiko-social cilësor për të gjithë personat e identifikuar në nevojë** për këtë lloj shërbimi, të prekur nga përjetimet e situatave emergjente si tërmeti apo covid 19. Psikologu do të synojë të lehtësojë dhe ndihmojë në menaxhimin dhe rindërtimin e dinamikave të shëndetshme psikologjike për familjet e identifikuar nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Bashkinë Krujë si pjesë e projektit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar për grupet vulnerabël si pasojë e vështirësive të shkaktuar nga emergjencat civile në Bashkinë Krujë” zbatuar nga Nisma ARSIS me mbështetjen e PNUD në Shqipëri në lidhje me programin “Forcimi i Reagimit të Mbrojtjes Sociale pas Tërmetit në Shqipëri”.

**Rreth Nisma ARSIS**

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht Nisma ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

**Rreth projektit**

Kjo nismë zbatohet në kuadër të projektit “Masat reaguese të mbrojtjes sociale pas tërmetit”, i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe i financuar nga Fondi i Përbashkët SDG dhe Fondi për Rimëkëmbjen e Tërmeteve. Projekti mbështet Qeverinë Shqiptare dhe tre bashki të prekura nga tërmeti, në hartimin dhe përkthimin e synimit të politikave në veprimet e duhura vendore për të siguruar që burrat, gratë, vajzat dhe djemtë që jetojnë në varfëri ose situata të cënueshme, që kryqëzohen me kushtet pas tërmetit, të kenë akses ndaj shërbimeve të integruara dhe cilësore sociale.

Projekti do të mbështesë Bashkinë Krujë, si një zonë e prekur nga tërmeti nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sociale cilësore dhe të integruara për fëmijë, nëna, dhe prindër që jetojnë në varfëri apo në situatë vulnerabël. Për të arritur këtë qëllim projekti do të fokusohet në ngritjen e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) në nivel Bashkie me rol specifik në trajtimin e grupeve vulnerabël dhe në nevojë për shërbime shoqërore, zhvillimin e detajuar të vlerësimit të nevojave në komunitetet e prekura nga tërmeti dhe njëkohësisht edhe nga pasojat e pandemisë COVID-19, dhe ofrimin e shërbimeve direkte shoqërore për tejkalimin e pasojave dhe vështirësive të krijuara nga tërmeti dhe COVID-19. Struktura Përgjegjëse për Shërbimet Shoqërore në kuadër të këtij projekti do të realizojë edhe hartimin e një plani veprimi lokal për përgjigjen ndaj emergjencave civile duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në situatë emergjence.

### **Grupet përfituese dhe aktorët kyç:**

- Fëmijë dhe familjet e tyre në situatë vulnerabël;
- Fëmijë dhe të rritur në situatë të lartë rreziku dhe në nevojë për mbështetje;
- Fëmijë dhe familjet e tyre të prekura nga tërmeti i Nëntor 2019;
- Punonjës të strukturave vendore si drejtoria e shërbimit social (NJMF, NJVNR, Koordinatori i dhunës, etj)arsimi, shëndetësia, etj.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Kthimi në normalitet pas përjetimit të një situatë emergjente është i domosdoshëm ndërsa sistemet e mbrojtjes sociale dhe strukturat e ofrimit të shërbimeve duhet të jenë më të përgatitur për të adresuar nevojat pas katastrofës.

Nevoja për shërbime psiko-sociale është e domosdoshme. Ky shërbim do të ofrohet i koordinuar me sektorët e Shëndetësisë dhe Edukimit, për të gjitha rastet e identifikuar në nevojë për këtë shërbim në territorin e bashkisë Krujë dhe Njësive administrative.

Ekipi psiko-social i përbërë nga një psikolog dhe punonjës social, me mbështetjen teknike të Nisma ARSIS, do të mundësojë ofrimin e një shërbimi psiko-social cilësor, i cili do të synojë të lehtësojë dhe ndihmojë përfituesit në menaxhimin dhe rindërtimin e dinamikave të shëndetshme psikologjike.

Roli dhe përgjegjësitë e psikologut si pjesë e ekipit psiko-social do të fokusohen në:

- Ofrimi i sesioneve të këshillimit dhe psiko-edukimi mbi stilet e prindërimit dhe përkujdesjes për anëtarët e familjeve të identifikuar në nevojë për këtë shërbim; Synohet targetimi i dinamikave familjare dhe praktikave të prindërimit pozitiv, me fokus edhe tek shëndeti mendor.
- Zhvillimi i aktiviteteve psiko-sociale me fëmijët dhe të rinjtë.
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere mbi çështje që lidhen me trauma të shkaktuara nga tërmeti apo pandemia.
- Zhvillimi i aktiviteteve passhkollore për fëmijët.
- Ofrimi i shërbimeve të këshillimit/mbështetje psiko-emocionale veçanërisht për fëmijët dhe gratë në nevojë për mbrojtje.
- Raportimin në kohë të aktiviteteve të zhvilluara dhe dokumentimin e ndërhyrjeve terapeutike tek individët në nevojë, plotësim i formave dhe database.
- Referimin për shërbime të specializuara në rastet e identifikuar me problematika të shëndetit fizik dhe mendor.

- Raportimin e rasteve në nevojë për mbrojtje si fëmijë apo të rritur ( raste të identifikuar gjatë aktiviteve apo punës në terren me vëmendje të shtuar ndaj rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare ).
- Ndërveprim dhe koordinim me Ekipin e Nisma Arsis dhe Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Krujë për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara.

#### **Kualifikime dhe eksperiencia e punës:**

- Diplomë universitare në fushën e shkencave sociale, Profili Psikologji Klinike;
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me zhvillimin e ndërhyrjeve klinike me fëmijë dhe të rritur
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe familjeve;
- Njohuri shumë të mira dhe eksperiencë të mëparshme në sistemin e mbrojtjes sociale;
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore;
- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 dhe të gjithë paketës ligjore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- Përvojë të punës në ekip për koordinimin e veprimeve për realizimin e planeve të ndërhyrjes ndaj individëve në nevojë;
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabel;
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARSIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe;
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e paketës MS Office

**Politikat e Mbrojtjes:** Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

**Koha e mundshme e fillimit të punës është 01 shkurt 2022.**

#### **Procedura e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi
- 2- Curriculum Vitae (evidenca të punëve të mëparshme të ngjashme);

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit: [initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com) deri në datën **24 janar 2022**, mesnatë, me subjekt: Aplikimi për “Psikolog në Bashkinë Krujë”

***Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistimit për pozicionin e psikologut do të kontaktohen.***